

VENDIM
Nr.638, datë 30.9.2004

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË DHËNIES ME KONCESION TË FORMËS “BOO”,
PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT TË HELMËSIT NË RRETHIN E KOLONJËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 7 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës dhe të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së dhënies me koncesion të formës “BOO” (ndërtim, pronësi, shfrytëzim), për ndërtimin e hidrocentralit të Helmësit në rrethin e Kolonjës, shoqërisë “PINDERI” sh.p.k., Kolonjë sipas propozimit të pakërkuar.

2. Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit të jenë Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA), për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes së koncesionit.

3. Ngarkohen Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës, Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano